



THIRRJE - DIGJITALIZO BIZNESIN PËRMES INICIATIVËS PËR FUQIZIM DIGJITAL (DEI)

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset kosovare të bëhen pjesë e Iniciativës për Fuqizim Digjital (DEI) dhe të përfitojnë nga shërbimet për digjitalizim. Përmes DEI, KIESA synon të përkrahë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MNVM) drejt transformimit digjital me qëllim që të rrisin performancën, konkurrueshmërinë dhe qasjen në treg.

Shërbimet e digjitalizimit

Shërbimet e digjitalizimit të ofruara në kuadër të DEI përfshijnë në fazën e parë:

- E-Commerce / Platformat e Shitjes Online
- Marketing-un Digjital
- Kontabiliteti Digjital dhe / ose HR
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP), dhe
- Programe të ndryshme automatizimi dhe optimizimi.

Kush mund të aplikojë

MNVM-të nga të gjithë sektorët mund të bëhen pjesë e DEI dhe të përfitojnë nga shërbimet e ofruara për digjitalizim. Inkurajohen për aplikim ndërmarrjet që menaxhohen nga gratë, që vijnë nga zona të disavantazuara, që ulin varfërinë, që promovojnë ekonomi të gjelbër, dhe ato që përfaqësojnë minoritetet.

Niveli i subvencioneve

Niveli i subvencioneve varet nga madhësia dhe qarkullimi i biznesi:

- Deri në 80% subvencion për ndërmarrjet me qarkullim <50,000 Euro
- Deri në 70% subvencion për ndërmarrjet me qarkullim 50,001 - 150,000 Euro
- Deri në 60% subvencion për ndërmarrjet me qarkullim 150,001 - 500,000 Euro
- Deri në 50% subvencion për ndërmarrjet me qarkullim >500,001 Euro

Shuma maksimale e subvencionimit për shërbime të transformimit digjital është 3000 Euro.



Kushtet për aplikim

- Biznesi është i formuar sipas ligjeve të Kosovës
- Biznesi nuk ka borxhe të papaguara ndaj ATK-së

Mënyra e aplikimit

Për të aplikuar ju duhet të dërgoni këto dokumente:

- Formularin për aplikim dhe deklaratën nën betim të ndërmarrjes të cilin e gjeni në uebfaqen e KIESA's nën seksionin e shpalljeve
- Vërtetimin tatimor që ndërmarrja nuk ka borxhe nga ATK
- Dëshminë mbi qarkullimin vjetor të vitit paraprak nga ATK

Dokumentet duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në adresën: sme.kiesa@rks-gov.net
Afati për aplikim është: **17 korrik 2020**

Iniciativa për Fuqizim Digjital përkrahët nga “Qasja në Treg dhe Shërbimet e Digjitalizimit për Bizneset Kosovare – ACCESS”, projekt i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik.